



## Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve dhe Edukimi Mjedisor në Bashkinë e Beratit

### Konteksti i projektit

Bashkia e Beratit është një zonë e zgjeruar nga reforma e fundit territorial të cilës i nevojitet një vlerësim dhe një plan zonimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në përputhje me Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Gjithashtu komunat përreth tashmë pjesë e Bashkisë së Beratit do të kenë nevojë për të unifikuar metodologjinë e mbledhjes së mbetjeve me qytetin e Beratit. Ky projekt do të ndihmojë Bashkinë e Beratit për të arritur këto objektive. Pa një skenar të projektit banorët në Bashkinë e Beratit do të vazhdojnë të depozitojnë mbetjet e tyre duke ndotur mjedisin dhe për këtë arsye kostot e mirëmbajtjes së qytetit do të rriten.



### Objektivi kryesor

Objektivi kryesor i këtij projekti është rritja e riciklimit, zgjerimi i mblulimit me shërbimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, duke mbuluar të gjithë qytetin e Beratit, pa komunat që janë bashkuar kohët e fundit, në përputhje me kërkesat e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, të cilat janë edhe kërkesë për integrimin në BE.

Projekti parashikon gjithashtu një Plan të Menaxhimit të Mbetjeve vetëm për Beratin, i përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me stafin e bashkisë si dhe me përfshirjen e pjesëtarëve të bashkësive qytetare, të cilat gjithashtu duhet të jenë të përditësuar me të rejtat më të fundit.

Projekti synon rikuperim në maksimum të mbetjeve nëpërmjet kompostimit, riciklimit, dhe ripërdorimit, dhe synon zero mbetje të hidhen në vend-depozitime dhe lëndfille. Objektivi afatgjatë është reduktimi i degradimit të mjedisit i shkaktuar nga mbetjet e ngurta.

### Komponentët kryesorë

1. Vlerësim i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në komunat e bashkuara së fundmi dhe planifikimi i menaxhimit të mbetjeve i këtyre komunave në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve të Beratit.
2. Rritja e ndërgjegjësimit publik në Bashkinë e Beratit për mbrojtjen e mjedisit, mësimi nga praktikatat më të mira dhe replikimi i tyre.
3. Promovimi i mbrojtjes mjedisore përmes praktikave më të mira dhe edukimi mbi mjedisin.

#### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

### FAKTET KRYESORE

#### DONATOR:

Ambasada Amerikane

#### PARTNER:

- Bashkia Berat

#### KOHEZGJATJA:

15 Tetor 2015 – 15 Prill 2016

#### PERFITUESIT:

- Bashkia Berat
- Komuniteti

#### KONTAKTI:

Zana Vokopola  
Drejtoresh Ekzekutive

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [zvokopola@uri.org.al](mailto:zvokopola@uri.org.al)